

Gjyqtare Albana Shtylla

Znj. Shtylla, e lindur në Vlorë në vitin 1970, u diplomua “juriste” në vitin 1992 në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2006, znj. Shtylla ka marrë diplomën “Master në Studime Evropiane” nga Universiteti i Tiranës, në vitin 2012 nga “Shkolla e Studimeve Politike” e Këshillit të Evropës dhe në vitin 2015 ka marrë gradën “Doktor i Shkencave në të drejtën publike” në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës.

Znj. Shtylla ka ndjekur kurse dhe trajnime për ngritjen e saj profesionale brenda dhe jashtë vendit. Eksperienca profesionale e saj përfshin angazhimin si juriste e nivelit drejtues në disa ministri, si këshilltare e drejtuese në institucione kushtetuese dhe si anëtare e institucioneve kushtetuese e të pavarura.

Ndër eksperiencat e znj. Shtylla vlen të veçohet ai i këshilltares ligjore në Kuvendin e Shqipërisë, drejtores së Drejtorisë Juridike dhe Integritetit në BE në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, drejtores së Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit dhe Oponencës në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, drejtores së kabinetit të Avokatit të Popullit, anëtares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtares së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe Sekretares së Përgjithshme të Kuvendit të Shqipërisë. Për një periudhë 7-vjeçare, znj. Shtylla ka qenë përfaqësuese e shtetit në Komitetin Ndërqeveritar të Këshillit të Evropës “Për Kartën Sociale Evropiane”.

Znj. Shtylla ka në tërësi një eksperiencë akademike rreth 15-vjeçare si pedagoge e jashtme dhe titullare lënde e “Së drejtës së punës” dhe “Së drejtës publike” në Shkollën e Magjistraturës dhe disa institucione të arsimit të lartë jopublik.

Me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Shtylla u zgjodh gjyqtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.